



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
Bordi i Administrimit

Nr. 2783 Prot

Shkodër, më 14.08.2019

**V E N D I M**

Nr. 277, datë 14.08.2019

**“PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E  
CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, PËR  
VITIN AKADEMIK 2019 – 2020 “**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3/ç, neni 6 pika 30, neni 38, 49; Ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr 778, datë 26.12.2018), Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Statutit të USH-së i vitit 2018, neni 5, neni 17, pika 6/nj; neni 28, si dhe vendimit të Senatit Akademik nr. 253, datë 17.07.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 14.08.2019,

**Vendosi**

1. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për programet e ciklit të parë me kohë të plotë viti akademik 2019 – 2020 sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për programet e ciklit të dytë me kohë të plotë viti akademik 2019 – 2020 sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët e ciklit të parë të cilësuar përsëritës sipas rregullores së Universitetit i nënshtrohen 100% tarifës totale vjetore të shkollimit.
4. Studentët e ciklit të parë që ndjekin studimet në vitin e dytë e të tretë e që në përfundim të vitit pararendës akademik rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) i nënshtrohen 100% tarifës totale vjetore të shkollimit.
5. Ngarkohet administratori për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Namik **KOPLIKU**



